



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:226869  
Datë: 18.12.2024  
Numri i dokumentit: 06618345

C-IV-23-0649

Parashtruesi i ankesës: R Gj të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokati B I nga Prishtina.

Kundër palës kundërshtare: Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga Dritan Hoxha,nr.55,Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarit Asllan Krasniqi, pas mbajtjes së seancës së datës 21.11.2024, ndërsa me datën;18.12.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

APROVOHET pjesërisht si bazuar ankesa e parashtruar nga R Gj nga Prishtina.

1.NDRYSHOHET vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit-Autoritetit të Likuidimit PRN029-0092, i datës 25.05.2015, ashtu që vendoset si në vijim: Detyrohet pala kundërshtare Agjencia Kosovare e Privatizimit-Autoriteti i Likuidimit për NSH “I.M.N KOSOVA”, që paditësit t’ia paguaj shumën prej 3,060.00 €, në emër të kompensimit për paga të papaguara përgjatë periudhës kohore nga dt.25 janar 2008 deri me dt. 25 janar 2011, si dhe shumën prej 306.00 € në emër të kamatës prej 10 % të shumës së detyrimit bazë në shumën e përgjithshme prej 3,366.00 € në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave të përcaktuara me ligjin e aplikueshëm për likuidimin e NSH-së.

II. REFUZOHET ankesa e parashtruar nga R Gj në shumën e kërkuar prej 595.00 €.

III. Detyrohet pala kundërshtare që t’ia paguaj parashtruesit të ankesës shumën prej 697.20 €, në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore.

## Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me datën 19.06.2015, pranë DHPGJS, ka parashtruar ankesë R Gj kundër palës kundërshtare Agjencisë Kosovare të Privatizimit lidhur vendimit me shkrim me numër PRN029-0092, të datës 25.05.2015, të lëshuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit me të cilin i ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e parashtruesit të ankesës për kompensimin e shumës prej 3,655.00 €, në emër të kompensimit të pagave të pa paguara për periudhën kohore nga 07.06.2007, e deri me 10.01.2011, nga NSH "IMN Kosova" (në likuidim).

Parashtruesi i ankesës në ankesë dhe parashtrimet tjera ndër të tjera ka theksuar se marrëdhënien e punës në ndërmarrje e ka filluar në vitin 1980, këtë e dëshmon librezja e punës. Në lidhje me pagat e pa paguara deri me datën 25.11.2011, kanë iniciuar procedurë gjyqësore në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Me vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së me datën 23.06.2014, ka filluar procedura e likuidimit të ndërmarrjes dhe me futjen e ndërmarrjes në procedurë të likuidimit të gjithë punëtorëve iu është ndërprerë marrëdhënia e punës. Pranë Autoritetit të Likuidimit ka parashtruar kërkesë për kompensim të pagave, ku ka kërkuar pagat për 43 muaj, për periudhën kohore nga data 07.06. 2007, e deri me datën 10.01.2011, në shumën prej 3,655.00 €. Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e tij dhe me vendim e ka refuzuar kërkesën për kompensim. Po ashtu ka pretenduar se vendimi i Autoritetit të Likuidimit është i përfshirë në zbatim të gabuar të të drejtës materiale. Autoriteti i Likuidimit i NSH-së nuk e ka kontestuar faktin se paditësi ka qenë punëtor i NSH-së, po ashtu nuk e ka kontestuar as lartësinë e kompensimit. Ka pretenduar se Autoriteti i Likuidimit gabimisht ka zbatuar nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar, ngase me hyrjen në fuqi të Ligjit për ndërmarrjet ligji në fjalë është shfuqizuar. Po ashtu ka theksuar se Autoriteti i Likuidimit i është referuar propozimit për përmbarrim ku ka konstatuar se i njëjti nuk është miratuar ngase nuk ka pasur bazë në ndonjë vendim të plotfuqishëm. Mirëpo propozimi për përmbarrim është iniciuar në bazë të dokumentit të besueshëm të përcaktuar në Ligjin për Procedurën Përmbarrimore.

Me rastin e refuzimit të përmbarrimit sipas dokumentit të besueshëm në bazë të dispozitave të LPK-së propozimi për përmbarrim në mënyrë automatike konsiderohet si padi. Me tutje ka shtuar se dorëzimi i propozimit për përmbarrim i cili me rastin e refuzimit konsiderohet si padi e ka ndërprerë në mënyrë automatike rrjedhën e afatit të parashkrimit të kërkesës. Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që ankesa e parashtruar të aprovohet në tërësi si e bazuar; të shfuqizohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit me numër PRN029-0092, i datës 25.05.2015; të detyrohet pala kundërshtare që në emër të kompensimit të pagave të pa paguara për periudhën nga data 07.06.2007 e deri me datën 10.01.2011, t'ia kompensoj shumën prej 3,655.00 €. Me datën 21.11.2024, gjykata ka caktuar seancë dëgjimore ku kanë prezantuar i parashtruesit të ankesës dhe përfaqësuesi i palës kundërshtare. Në këtë seancë dëgjimore gjykata ka kërkuar nga palët ndërgjyqëse vendimin përfundimtar në lidhje me propozimin për përmbarrim i deponuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Me datën 26.11.2024, i autorizuar i palës paditëse ka parashtruar pranë gjykatës vendimin me numër C-II-15-0340-C0001, me të cilin është pezulluar procedura.

Në këtë çështje juridike janë administruar si prova:

- *Kopjen e librezës së punës;*
- *Propozimin për përmbarim të parashtruar në Gjykatën Komunale në Prishtinë me dt.05.01.2011;*
- *Regjistrin e punëtoreve të cilët kanë parashtruar propozim për përmbarim;*
- *Kopjen e vendimit për fillimin e procedurës së likuidimit të NSH-së;*
- *Kopjen e vendimit të AL me nr. PRN029-0092, të datës 25.05.2015; dhe*
- *Vendimin me numër C-II-15-0340-C0001, me të cilin është pezulluara procedura.*

Me datën 15.09.2017, AKP-ja përmes përfaqësuesit të sajë ka paraqitur mbrojtjen, ndaj ankesës së parashtruar nga pala paditëse, në mbrojtjen e parashtruar ndër të tjera ka theksuar se NSH I.M.N Kosova (në likuidim), ka hyrë në procedurën e likuidimit me datën 23.06.2014. Me datën 08.07.2014, parashtruesi i ankesës ka parashtruar një kërkesë, me të cilën ka kërkuar kompensimin e shumës prej 3,655.00 €, në emër të kompensimit të pagave të pa paguara për periudhën kohore nga data 07.06.2007, e deri me datën 11.01.2011.2009.

Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga pala paditëse në atë procedurë dhe me vendimin me numër PRN029-0092, të datës 25.05.2015, kërkesën e parashtruar nga pala paditëse e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar. Vendimin e vet Autoriteti i Likuidimit e ka bazuar në nenin 36.2.1, të Ligjit me numër 04/L-034, dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar.Me tutje në mbrojtjen e parashtruar ka theksuar se i përmbahet qëndrimit se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe saktë ka zbatuar edhe dispozitat ligjore.

Objekt i shqyrtimit në këtë çështje juridike është ligjshmëria e vendimit të Autoritetit të Likuidimit dhe se parashtruesi i ankesës nuk ka treguar me ankesë se cila dispozitë e Ligjit me numër 04/L-034, është shkelur nga ana e Autoritetit të Likuidimit me rastin e vendosjes në kërkesën e parashtruar në procedurën e likuidimit.Po ashtu ka theksuar se parashtruesi i ankesës pretendon në paga të pa kompensuara për periudhën kohore 2007-2011, dhe si provë ka dorëzuar propozimin për përmbarim me pretendimin se me dorëzimin e propozimit për përmbarim rrjedha e afatit të parashkrimit është ndërprerë. Mirëpo në momentin e dorëzimit të propozimit për përmbarim në gjykatë kërkesa e tij ishte e parashkruar, ngase kërkesa i përket periudhës së vitit 2007, ndërsa propozimin për përmbarim në gjykatë e ka dorëzuar në vitin 2011. Kështu që në kuptim të nenit 608, të Ligjit për Punën e Bashkuar kërkesa e tij është e parashkruar.

Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që ankesën e parashtruar nga pala paditëse ta refuzoj si të pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL në pajtim me nenin 70.4 të Shtojcës së Ligjit me numër 04/L-033.

### Arsyetimi Ligjor

Pas shqyrtimit të provave të lëndës, pretendimeve dhe parashtrimeve të palëve në procedurë gjykata ka ardhur në përfundimin se ankesa e parashtruar nga R Gj është pjesërisht e bazuar.

Pas shqyrtimit të pretendimeve, parashtrimeve të palëve në procedurë dhe provave të lëndës gjykata ka gjetur se NSH I.M.N Kosova, ka hyrë në procedurë të likuidimit me datën 23.06.2014. Parashtruesi i ankesës me datën 08.07.2014, ka parashtruar një kërkesë pranë AL-së,përmes të

të cilës ka kërkuar kompensimin e shumës prej 3,655.00 €, në emër të kompensimit të pagave të pa paguara për periudhën kohore nga data 07.06.2007 e deri me datën 11.01.2011. Pala kundërshtare e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar dhe me vendimin me numër PRN029-0092, të datës 25.05.2015, e ka refuzuar kërkesën për kompensimin e shumës së kërkuar me pretendimin se në kuptim të nenit 608 të LPB-së, kërkesa e parashtruar është e parashkruar. Objekt i shqyrtimit nga gjykata ishte çështja e parashkrimit e ngritur nga pala kundërshtare.

Gjykata potencon se sikurse legjislacioni që ishte në fuqi para vitit 1998/99, ashtu edhe ligjet që janë miratuar pas viteve 1998/1999, e kanë ruajtur afatin tre (3) vjeçar të parashkrimit të kërkesave monetare nga lëmi i marrëdhënies së punës. Me Ligjin për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76), neni 608 parashihej se *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës, do të jetë e parashkruar për tri vite”*. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), i vitit 1978 (Ligj nr. 690), neni 372.1 përcaktonte se *afati i parashkrimit të kërkesave periodike është tri vite, nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë*. Ligji i Punës, i vitit 2010 (Ligj nr. 03/L-212), neni 87, përcakton se *të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*. Edhe LMD i ri, i vitit 2012 (Ligj nr. 04/L-077), neni 353.1, ka përcaktuar se *“Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike) ... parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë”*. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore, rezulton se afati i parashkrimit të kërkesave monetare nga marrëdhënia e punës, është tri vite, nga dita e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç.

Pas vlerësimeve të bëra në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesa për pagat e papaguara që i takojnë periudhës Janar 2008 – Janar 2011, nuk është parashkruar, ndërsa kërkesa për pagat e tjera të mëhershme, është parashkruar. Propozimi për përmbarim i paraqitur nga paditësi me datën 25.01.2011, e ka ndërprerë parashkrimin, për tri vitet paraprake, respektivisht për pagat që i takojnë periudhës nga Janar i vitit 2008 e më tutje. Ndërsa pagat e mëhershme e kanë arritur afatin tre vjeçar të parashkrimit, para se të paraqitet propozimi për përmbarim. Gjykata ka ardhur tek ky konstatim, në mbështetje të nenit 369 të LMD-së, ku është përcaktuar se *“Parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”*. Pra, me paraqitjen e propozimit për përmbarim, pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë, si autoritet i atëhershëm kompetent për ekzekutim e detyrimeve, është ndërprerë afati i parashkrimit tri vite prapa. Rrjedhimisht, gjykata ka ardhur në përfundimin se nuk janë parashkruar detyrimet e palës kundërshtare përkitazi me paga e mbetura të papaguara gjatë periudhës 25 janar 2008 - 10 janar 2011, ndërsa pagat e kërkuara që i përkasin periudhës para muajit Janar 2008, janë të parashkruara dhe si të tilla nuk mund të jenë objekt i mbrojtjes gjyqësore. Gjatë asaj periudhe paditësi i kanë takuar gjithsej 36 paga mujore, prej nga 85.00 €, gjë krijojnë shumën e përgjithshme prej 3,060.00 €, sa janë aprovuar edhe me këtë aktgjykim.

Në pjesën tjetër të saj, gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të ankesës si të pabazuar, për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit, duke vendosur ashtu si është specifikuar në pikën dy të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kamatën e vonesës është i bazuar në neni 37.3 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme, ku është përcaktuar se *“Të gjitha Kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore”*.

Përfundimisht gjykata duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartë cekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më sipër ka vendosur ashtu si është përcaktuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

*Shpenzimet Gjyqësore:*

Me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 62, paragrafi 1 dhe 2, është përcaktuar se *“Aktgjykimi i formës së prerë lidhur me një kërkesë apo ankesë duhet të përfshijë një vendim për shpenzimet e lëndës në mes të palëve. Pala e pasuksesshme urdhërohet t'i paguajë shpenzimet ashtu siç përcaktohen me aktgjykimin e formës së prerë”*. Në këtë çështje kontestimore, i autorizuari i parashtruesit të ankesës ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve gjyqësore, ndërsa pala kundërshtare nuk i ka kërkuar ato. Gjykata, konform dispozitave të lartpërmendura, në pajtim me Udhëzimin Administrativ për Taksat Gjyqësore dhe Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës, ia ka njohur parashtruesit të ankesës të drejtën në kompensimin e shpenzimeve procedurale, pasi që i njëjti i ka specifikuar me parashtrësën e hartuar me shkrim të datës;26.11.2024.

*Këshillë Juridike:*

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim, duke iu drejtuar Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, brenda afatit kohor prej 15 ditësh, llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari  
Asllan Krasniqi